L I G J
Nr. 8939, datë 12.9.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NR. 175 "PUNA ME KOHË TË PJESSHME, 1994" TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet "Konventa nr.175 "Puna me kohë të pjesshme, 1994" e Organizatës Ndërkombëtare të Punës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3482, datë 7.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA NR. 175
KONVENTA LIDHUR ME PUNËN ME KOHË TË PJESSHME

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe e mbledhur më 7 qershor 1994, në sesionin e saj të 81-të;

duke nënvizuar rëndësinë, për punonjësit me kohë të pjesshme, të dispozitave të konventës mbi barazinë e shpërblimit, 1951; të konventës lidhur me diskriminimin (punësim dhe profesion), 1958; dhe të konventës dhe rekomandimit mbi punonjës që kanë përgjegjësi familjare, 1981;

duke nënvizuar gjithashtu rëndësinë, për këta punonjës, e konventës mbi nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia, 1988, dhe të rekomandimit lidhur me politikën e punësimit (dispozita plotësuese), 1984;

duke njohur rëndësinë që merr për të gjithë punëtorët një punësim produktiv dhe i zgjedhur lirisht, rëndësinë e punës me kohë të pjesshme për ekonominë, nevojën për politikat e punësimit për të marrë në konsideratë rolin që luan puna me kohë të pjesshme në krijimin e mundësive suplementare të punësimit dhe nevojën për të siguruar mbrojtjen e punonjësve me kohë të pjesshme në fushat e aksesit në punësim, kushteve të punës dhe sigurimeve shoqërore;

pasi kanë vendosur të miratojnë propozime të ndryshme lidhur me punën me kohë të pjesshme, çështje që përbën pikën e katërt të rendit të ditës së sesionit;

pasi kanë vendosur që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare.

Miraton, ditën e 24 qershorit 1994, Konventën e mëposhtme, e cila do të quhet Konventa mbi punën me kohë të pjesshme, 1994.

Neni 1

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) shprehja “punonjës me kohë të pjesshme” tregon një punonjës rrogëtar, kohëzgjatja normale e të cilit është më e ulët se ajo e punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në një situatë të krahasueshme;

b) kohëzgjatja normale e punës e përmendur në paragrafin a) mund të llogaritet mbi një bazë javore ose mesatarisht gjatë një periudhe punësimi të dhënë;

c) shprehja “punonjës me kohë të plotë i ndodhur në një situatë të krahasueshme” i referohet një punëtori me kohë të plotë:

- që ka të njëjtin tip marrëdhënieje punësimi;
- që kryen të njëjtin tip pune ose një tip pune të ngjashëm, ose që ushtron të njëjtin tip profesioni, ose një tip profesioni të ngjashëm;
- i punësuar në të njëjtin institucion ose, në mungesë të punonjësve me kohë të plotë, i ndodhur në një situatë të krahasueshme në këtë institucion, në të njëjtën ndërmarrje ose, në mungesë të punonjësve me kohë të plotë, i ndodhur në një situatë të krahasueshme në këtë ndërmarrje, në të njëjtën degë aktiviteti, si punëtori i përmendur me kohë të pjesshme;

d) punonjësit me kohë të plotë në papunësi të pjesshme, domethënë të prekur nga një reduktim kolektiv dhe i përkohshëm i kohëzgjatjes së tyre normale të punës për arsye ekonomike, teknike apo strukturore, nuk konsiderohen si punonjës me kohë të pjesshme.

Neni 2

Kjo Konventë nuk prek dispozitat më të favorshme të konventave të tjera ndërkombëtare të zbatueshme ndaj punonjësve me kohë të pjesshme.

Neni 3

1. Kjo Konventë zbatohet mbi të gjithë punonjësit me kohë të pjesshme, duke ditur që një Anëtar mund, pas konsultash me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve të interesuar, të përjashtojë plotësisht apo pjesërisht nga fusha e saj e aplikimit kategori të veçanta punonjësish apo ndërmarrjesh, kur zbatimi i saj ndaj tyre ngre probleme të veçanta të një rëndësie që nuk mund të neglizhohet.

2. Çdo Anëtar i cili ratifikon këtë Konventë dhe që zbaton mundësinë e ofruar në paragrafin paraardhës duhet, në raportet e tij mbi aplikimin e Konventës të paraqitura sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të tregojë çdo kategori të veçantë punonjësish apo ndërmarrjesh të përjashtuara, si dhe arsyet për të cilat ky përjashtim ka qenë dhe mbetet i nevojshëm.

Neni 4

Duhen marrë masa me qëllim që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë të njëjtën mbrojtje si ajo që përfitojnë punonjësit me kohë të plotë; duke u ndodhur në një situatë të krahasueshme për sa i përket:

a) të drejtës së organizimit, të drejtës së negocimit kolektiv dhe të drejtës së veprimit në cilësinë e përfaqësuesve të punëmarrësve;

b) sigurisë dhe shëndetit në punë;

c) diskriminimit në punësim dhe në profesion.

Neni 5

Duhen marrë masa, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, që punonjësit me kohë të pjesshme të mos marrin, për të vetmen arsye se ata punojnë në kohë të pjesshme, një rrogë bazë, e cila, e llogaritur në mënyrë proporcionale mbi një bazë orësh, rendimenti apo me copë, të jetë më e vogël se rroga bazë, e llogaritur sipas të njëjtës metodë, e punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në të njëjtën situatë të krahasueshme.

Neni 6

Regjimet legale të sigurisë sociale që janë të lidhura me ushtrimin e një aktiviteti profesional duhet të përshtaten në mënyrë të tillë që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë nga kushtet ekuivalente me ato të punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në një situatë të krahasueshme; këto kushte do të mund të përcaktohen në proporcion me kohëzgjatjen e punës, kuotizacionet ose fitimet, ose me metoda të tjera, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare.

Neni 7

Duhen marrë masa, me qëllim që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë nga kushte ekuivalente me ato të punonjësve me kohë të plotë të ndodhur në një situatë të krahasueshme në fushat e mëposhtme:

a) mbrojtja e mëmësisë;

b) ndërprerja e marrëdhënieve të punës;

c) leje vjetore e paguar dhe ditë pushimi (festash) të paguara;

d) pushime për sëmundje;

duke ditur që këto pagesa në para do të mund të përcaktohen në proporcion me kohëzgjatjen e punës apo fitimin.

Neni 8

1. Punonjësit me kohë të pjesshme, kohëzgjatja e punës apo fitimi i të cilëve janë më të ulta se disa pragje të përcaktuara, do të mund të përjashtohen nga Anëtari:

a) nga fusha e zbatimit të ndonjërit prej regjimeve ligjore të sigurimeve shoqërore të parashikuar në nenin 6, me përjashtim të rasteve të pagesave për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;

b) nga fusha e zbatimit e ndonjërës prej masave të miratuara në fushat e përmendura në nenin 7, me përjashtim të masave mbrojtëse të mëmësisë, përveç atyre që janë parashikuar nga regjimet legale të sigurimeve shoqërore.

2. Pragjet e përmendura në paragrafin 1 duhet të jenë në mënyrë të mjaftueshme të ulta për të mos përjashtuar një përqindje të lartë pa të drejtë të punonjësve me kohë të pjesshme.

3. Një Anëtar që përfiton nga mundësia e parashikuar në paragrafin 1 si më sipër duhet:

a) të rishikojë periodikisht pragjet në fuqi;

b) të saktësojë, në raportet e tij mbi zbatimin e konventës të paraqitur, në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, pragjet në fuqi dhe arsyet e tyre dhe të tregojë nëse synohet të shtrihet progresivisht mbrojtja ndaj punonjësve të përjashtuar.

4. Organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe të punëmarrësve duhet të konsultohen në lidhje me fiksimin, rishqyrtimin dhe rishikimin e pragjeve të parashikuara në këtë nen.

Neni 9

1. Duhen marrë masa për të lehtësuar aksesin në punën me kohë të pjesshme produktive dhe e zgjedhur në mënyrë të lirë, e cila u përgjigjet si nevojave të punëdhënësve, ashtu dhe të punëmarrësve, me kusht që mbrojtja e parashikuar në nenet 4 dhe 7, si më sipër të jetë e siguruar.

2. Këto masa duhet të përmbajnë:

a) rishqyrtimin e dispozitave të legjislacionit, që mund të pengojnë ose të inkurajojnë punën me kohë të pjesshme ose pranimin e këtij tipi pune;

b) përdorimin e shërbimeve të punësimit kur ato ekzistojnë për t'i identifikuar dhe për t'i bërë të njohura mundësitë e punës me kohë të pjesshme gjatë veprimtarive të tyre informuese dhe ndërmjetësuese;

c) një vëmendje të veçantë, në kuadrin e politikave të punësimit, ndaj nevojave dhe preferencave të grupeve specifike të tillë si të papunë, punonjës që kanë përgjegjësi familjare, punonjës të moshuar, punonjës hendikap dhe punonjës që punojnë ose janë në formim (kualifikim).

3. Këto masa mund të përmbajnë, gjithashtu, kërkime dhe shpërndarjen e informacioneve mbi

masën në të cilën puna me kohë të përkohshme u përgjigjet objektivave ekonomike dhe sociale të punëdhënësve dhe punëmarrësve.

Neni 10

Në rastet e duhura, duhen marrë masa me qëllim që transferta nga një punë me kohë të plotë në një punë me kohë të pjesshme ose e anasjellta, të jetë vullnetare, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare.

Neni 11

Dispozitat e kësaj Konvente duhet të vihen në jetë nëpërmjet legjislacionit, përveçse kur atyre u jepet fuqi me anë të marrëveshjeve kolektive ose me çdo lloj mjeti tjetër në përputhje me praktikën kombëtare. Organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve duhet të konsultohen paraprakisht për miratimin e një legjislacioni të tillë.

Neni 12

Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente do t'i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe do të regjistrohen prej tij.

Neni 13

1. Kjo konventë do të lidhë vetëm Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i së cilës do të ketë qenë i regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Ajo do të hyjë në fuqi 12 muaj pasi ratifikimet e dy Anëtarëve do të kenë qenë të regjistruara nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Më pas, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës në të cilën ratifikimi i saj do të jetë regjistruar.

Neni 14

1. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë në mbarim të një periudhe dhjetëvjeçare pas datës së hyrjes fillestare në fuqi të Konventës, me anë të një akti që i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe të regjistruar prej tij. Denoncimi do të marrë forcë vetëm pas një viti nga regjistrimi i saj.
2. Çdo Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë, i cili, në afatin e një viti pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare të përmendur në paragrafin e mësipërm nuk do të përdorë të drejtën e denoncimit të parashikuar nga ky nen, do të lidhet për një periudhë të re dhjetëvjeçare, dhe, në vazhdim, do të mund të denoncojë këtë Konventë në mbarim të çdo periudhe dhjetëvjeçare në kushtet e parashikuara në këtë nen.

Neni 15

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i njoftojë të gjithë Anëtarëve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që do t'i komunikohen atij nga Anëtarët e Organizatës.
2. Duke u njoftuar Anëtarëve të Organizatës regjistrimin e ratifikimit të dytë që do t'i jetë komunikuar atij, Drejtori i Përgjithshëm do të tërheqë vëmendjen e Anëtarëve të Organizatës mbi datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi.

Neni 16

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, për qëllime regjistrimi, në përputhje me nenin 102 të Kartës

së Kombeve të Bashkuara, të dhëna të plota lidhur me çdo ratifikim ose akt denoncimi që ai do të ketë regjistruar në përputhje me nenet e mësipërme.

Neni 17

Sa herë që do ta gjykojë të nevojshme, Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të punës do t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi zbatimin e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë, nëse ka vend, regjistrimin në rendin e ditës të çështjes së rishikimit të saj total ose të pjesshëm.

Neni 18

1. Në rastin kur Konferenca do të miratonte një konventë të re, që do të rishikonte në mënyrë të plotë ose të pjesshme këtë Konventë, dhe nëse konventa e re nuk parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një Anëtar i konventës së re që bën rishikimin, do të sillte me plot të drejtë, pavarësisht nenit 14 më sipër, denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, me kusht që konventa e re që bën rishikimin të ketë hyrë në fuqi;

b) duke u nisur nga data e hyrjes në fuqi të konventës së re që përmban rishikim, kjo Konventë do të pushonte së qeni e hapur për ratifikim të Anëtarëve.

2. Kjo Konventë do të mbetej megjithatë në fuqi në formë dhe në përmbajtje për Anëtarët që do ta kishin ratifikuar dhe që nuk do të ratifikonin Konventën që përmban rishikim.

Neni 19

Versionet frengjisht dhe anglisht të tekstit të kësaj Konvente janë të njëjtë.